



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
DREJTORIA E EDUKIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 9998 prot.

Tiranë, më 27/07 2010



MARATOHET

MINISTRI


MYQEREM TAFAJ

RREGULLORE
E
VLERËSIMIT TË NXËNËSIT
NË GJIMNAZ

Tiranë, korrik 2010

PËRMBAJTJA

1. KREDITET	4
2. MATURA SHTETËRORE	6
3. VLERËSIMI I NXËNËSIT	8
4. KRITERET E MARRJES SË DIPLOMËS SË GJIMNAZIT	14
Shtojcë 1	15

1. *Rregullorja e Vlerësimit të Nxënësit në Gjinnaz* është e vlefshme për kurrikulën e re të gjimnazit dhe nxënësit që përfundojnë klasën e 12-të në vitin 2012.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për nxënësit që ndjekin klasën e 12-të në vitin shkollor 2010-2011.

1. KREDITET

Çdo lëndë e kurrikulës bërthamë dhe e kurrikulës me zgjedhje ka një numër të përcaktuar kreditesh (Kr).

Për klasën e 10-të dhe të 11-të, numri i krediteve (Kr) të një lënde ose moduli gjendet duke pjesëtuar numrin e orëve vjetore të lëndës në planin mësimor me 36¹.

$$1. \text{ Kr}_{(10,11)} = \frac{\text{Numri i orëve në planin mësimor}}{36}$$

Për klasën e 12-të numri i krediteve të një lënde ose moduli gjendet duke pjesëtuar numrin e orëve vjetore të lëndës në planin mësimor me 33.

$$2. \text{ Kr}_{(12)} = \frac{\text{Numri i orëve në planin mësimor}}{33}$$

Shembull:

a. Matematika e kurrikulës bërthamë për klasën e 10-të ka 3 kredite, sepse:

$$\frac{108 \text{ (orë në planin mësimor)}}{36} = 3 \text{ kredite}$$

b. Matematika e kurrikulës bërthamë për klasën e 12-të ka 4 kredite, sepse:

$$\frac{132 \text{ (orë në planin mësimor)}}{33} = 4 \text{ kredite}$$

c. Shërbimi komunitar ka 1/2 krediti sepse:

$$\frac{18 \text{ (orë në planin mësimor)}}{36} = 1/2 \text{ kredite.}$$

d. Përforcimi ka 1 kredit sepse $36:36=1$.

$$\frac{36 \text{ (orë në planin mësimor)}}{36} = 1 \text{ kredit}$$

¹ 36 dhe 33 janë përkatësisht numri i javëve në klasën e 10-të, 11-të dhe në klasën e 12-të sipas strukturës së vitit shkollor.

e. Një modul që ka 10 orë mësimore në klasën e 12 ka 0,3 kredite sepse:

$$\frac{10 \text{ (orë në planin mësimor)}}{30} = 0.3^2 \text{ kredite}$$

33

1.1 Kriteret për kreditet

Kriteret që duhen përmbushur për përfitim të krediteve në gjimnaz janë si më poshtë vijon:

- 1) Numri më i vogël i krediteve që një nxënës duhet të sigurojë në gjimnaz është 90.
- 2) Numri i krediteve që i përkasin kurrikulës bërthamë është 73 dhe numri i krediteve të kurrikulës me zgjedhje të lirë dhe të detyruar është 17.
- 3) Numri i krediteve të kurrikulës me zgjedhje të detyruar mund të jetë 10-12, kurse numri i krediteve të kurrikulës me zgjedhje të lirë mund të jetë 5-7.
- 4) Kur një gjimnaz zgjedh dhe mundëson të zhvillojë më shumë se 30 orë në javë, lëndët për orët shtesë (mbi 30) përzgjidhen nga kurrikula me zgjedhje të detyruar. Në këto orë shtesë, nxënësi mund të zgjedhë edhe lëndë me zgjedhje të detyruar të planifikuara në klasa të tjera³.
- 5) Nxënësi që, në fund të një viti shkollor është kalues në lëndët bërthamë, por mbetet në lëndë/module me zgjedhje kalon klasën, por **nuk fiton** kreditet përkatëse. Nxënësi ka të drejtë t'i fitojë këto kredite në klasat pasardhëse në po ato lëndë/module ose në të tjera të përzgjedhura prej tij.
- 6) Nxënësit që mbetet në klasë nuk i njihen kreditet e fituara në atë klasë, me përjashtim të atyre të fituara për shërbimin komunitar dhe modulet profesionale të cilat dëshmohen me certifikatë.

² Numri i krediteve rumbullakoset me një shifër pas presjes dhjetore.

³ Për shembull nxënësi në klasën e 12-të mund të përzgjedhë lëndën sociologji, të planifikuar për klasën e 11-të.

2. MATURA SHTETËRORE

Nxënësi pranohet në provimet e maturës shtetërore nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

- ka kaluar në të tri klasat e gjimnazit
- ka fituar të paktën 90 kredite gjatë gjimnazit
- ka fituar 10-12 kredite për kurrikulën me zgjedhje të detyruar dhe 5-7 kredite për kurrikulën me zgjedhje të lirë
- ka fituar të paktën 1 kredit për modulet profesionale
- ka fituar 0.5 kredite për shërbimin komunitar
- ka fituar 0.5 kredite për projektet kurrikulare

Matura shtetërore përmban:

- **Provimet në lëndët e njëjta dhe të detyruara për të gjithë nxënësit**
- **Provimet në lëndët me zgjedhje**

2.1 Lëndët e provimit të maturës shtetërore, të njëjta dhe të detyruara për të gjithë nxënësit janë:

- Gjuhë Shqipe dhe letërsi
- Matematikë
- Gjuhë e Huaj e Parë

2.2 **Provimet në lëndët me zgjedhje**

Kritere për përzgjedhjen e lëndëve me zgjedhje

Konsiderohen tri lëndë më vete lëndë të tilla si: fizika bërthamë, fizika e zbatuar dhe fizika e avancuar.

- 1) Nxënësi i përzgjedh lëndët për provimin me zgjedhje nga grupi i lëndëve bërthamë dhe lëndëve me zgjedhje të detyruar.
- 2) Nxënësit duhet të sigurojnë një numër të caktuar kreditesh në provimet e lëndëve me zgjedhje.

- 3) Numri më i vogël i krediteve të detyruara për t'u fituar në provimet e lëndëve me zgjedhje është 8.
- 4) Numri i lëndëve që nxënësi duhet të përzgjedhë për provimin në lëndët me zgjedhje është jo më pak se dy dhe jo më shumë se katër lëndë.

Shembull:

Në zbatim të kriterëve të mësipërme, në provimet e lëndëve me zgjedhje, nxënësi mund të përzgjedhë kombinimet e lëndëve si më poshtë:

Kombinime lëndësh	Gjithsej
1. Biologji bërthamë (4 kredite) 2. Kimi bërthamë (4 kredite)	8 kredite
1. Biologji bërthamë (4 kredite) 2. Kimi bërthamë (4 kredite) 3. Kimi e thelluar (2 kredite)	10 kredite
1. Gjuhë e huaj e dytë (6 kredite) 2. Histori e klasës së 11-të (2 kredite)	8 kredite
1. Gjuhë e huaj e dytë (6 kredite) 2. Histori bërthamë (5 kredite)	11 kredite
1. Psikologji (2 kredite) 2. Filozofi (2 kredite) 3. Sociologji (2 kredite) 4. Qytetari (3 kredite)	9 kredite

Kur nxënësi mbetet në një ose më shumë lëndë të maturës shtetërore i jepet e drejta për ti ridhënë ato vetëm në vitin/vitet pasardhëse të maturës shtetërore.

Nxënësi nuk i nënshtrohet provimeve të maturës shtetërore për lëndët në të cilat është kalues.

Nxënësi që është mbetës në lëndët me zgjedhje të maturës shtetërore ka të drejtë të përzgjedhë për të dhënë provim në vitin/vitet pasardhëse lëndë të tjera me zgjedhje me kusht që shuma e krediteve të lëndëve me zgjedhje të jetë të paktën 8.

3. VLERËSIMI I NXËNËSIT

Vlerësimi i nxënësit në gjimnaz bëhet me notë dhe me pikë.

3.1. Vlerësimi me notë

Mësuesi i lëndës llogarit notën vjetore (semestrare⁴) për çdo nxënësi.

Gjatë vitit (semestrit) nxënësi vlerësohet:

- Për përgjigjet me gojë
- Për përgjigjet me shkrim
- Për arritjet në projektet kurrikulare

Nota vjetore (semestrare) në një lëndë nuk llogaritet si mesatare e thjeshtë aritmetike, por sipas skemës (modelit) të mëposhtëm:

Lloji i vlerësimit	Pesha të përafërta	Mesatarja
Vlerësimi ditor	20%	M ₁
Vlerësimi përmblledhës (kapitull, grup kapitujsh etj.)	50%	M ₂
Vlerësimi i projekteve kurrikulare (me gojë dhe me shkrim)	30%	M ₃

⁴Nota semestrare nuk merret parasysh në llogaritjen e notës vjetore. Ajo i vlen nxënësit, prindërve të tij dhe mësuesve për të ndjekur ecurinë e përvetësimit të dijeve të nxënësit.

Nota vjetore (semestrare) përlllogaritet sipas hapave të mëposhtëm:

- Hapi i parë: llogaritet mesatarja aritmetike M_1 e vlerësimeve ditore.
- Hapi i dytë: llogaritet mesatarja M_2 e vlerësimeve përmbledhëse.
- Hapi i tretë: llogaritet mesatarja M_3 e vlerësimeve për projektet kurrikulare.

Nota vjetore (semestrare) gjendet sipas formulës së mëposhtme që ka për bazë mesataret M_1 , M_2 , M_3 :

$$N^5 = 0,2 \times M_1 + 0,5 \times M_2 + 0,3 \times M_3$$

Në një lëndë duhet zhvilluar mesatarisht një detyrë me shkrim për kapitull në të paktën çdo 18 orë mësimore.

Numri i orëve mësimore për projekte kurrikulare duhet të jetë të paktën 1 orë në çdo 18 orë mësimore.

⁵ N=Nota Vjetore

3.2.Vlerësimi me pikë

Vlerësimi me pikë i nxënësit bëhet sipas parimeve të mëposhtme:

- 1) Lëndët kanë pesha të ndryshme në vlerësimin me pikë të nxënësit.
- 2) Pesha e një lënde në vlerësimin me pikë përcaktohet nga numri i krediteve të saj dhe koeficienti përkatës.
- 3) Koeficienti për lëndët me programe të thelluara është 1,4.
- 4) Koeficienti për lëndët e tjera është 1⁶.

3.2.1. Llogaritja e pikëve për një klasë(shembull)

KLASA E 10-të

Nxënës/i-ja

Lëndët/modulet	NOTAT	KREDITET	KOEFICIENTI	PIKËT
A. KURRIKULA BËRTHAMË				
Arte	8	1	1	8
Edukim fizik dhe sporte	7	1	1	7
Gjuhë e huaj e parë	7	2	1	14
Gjuhë shqipe dhe letërsi	7	3	1	21
Karriera, aftësimi për jetën	8	1	1	8
Matematikë	10	3	1	30
Kimi	5	2	1	10
Fizikë	6	2	1	12
Biologji	8	2	1	16
Shkenca e tokës, mjedisit dhe hapësirës	6	2	1	12
Qytetari	7	2	1	14
Histori	5	3	1	15
TIK	9	2	1	18

⁶ Shih tabelën e koeficienteve në Shtojcën 1.

B. KURRIKULA ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR				
Matematikë e thelluar	9	2	1.4	25.2
C. KURRIKULA ME ZGJEDHJE TË LIRË				
Guida turistike	8	1	1	8
Përforcim: Kimi	v			
SHUMA		29		218.2

3.2.2. Llogaritja e pikëve për të tri klasat e gjimnazit

Në llogaritjen e shumës së pikëve të gjimnazit (ΣP) përfshihen vetëm lëndët/modulet/projektet që vlerësohen me notë.

Për të nxjerrë pikët e tri klasave të gjimnazit mblidhen pikët e klasës së 10-të, 11-të dhe të 12-të gjimnazit (të përlllogaritura si më sipër)⁷.

3.3. Mesatarja e ponderuar për tri klasat e gjimnazit (Mp)

Mesatarja e ponderuar (Mp) e gjimnazit llogaritet duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të pikëve që nxënësi ka fituar gjatë gjimnazit me shumën e krediteve të lëndëve në të cilat nxënësi është vlerësuar me notë.

Lëndët / modulet në të cilat nxënësi nuk vlerësohet me notë në gjimnaz janë:

- përforcimi
- shërbimi komunitar
- modulet profesionale (të cilat vlerësohen me certifikatë)

⁷Numri minimal i pikëve që nxënësi mund të marrë në mbarim të tre viteve të gjimnazit është 427.5, kurse ai maksimal është 1009.

Shembull:

Nota mesatare e ponderuar (Mp) e nxënësit që ka fituar në tri vitet e gjimnazit 862 pikë dhe 88 kredite gjithsej është:

$$M_p = \frac{\sum P}{\sum K_r}$$

$$M_p = 862 : 88 = 9.79$$

3.4. Mesatarja e ponderuar e maturës shtetërore (MpM)

3.4.1. Llogaritja e pikëve të maturës shtetërore

- 1) Lëndët në provimet e maturës shtetërore (si të njëjtat ashtu dhe ato me zgjedhje) kanë pesha të ndryshme në vlerësimin me pikë të nxënësit.
- 2) Pesha e një lënde në provimet e maturës shtetërore përcaktohet nga numri i krediteve të lëndës së planifikuar në planin mësimor dhe koeficienti përkatës.

Lëndët	NOTAT	KREDITET	KOEFICIENTI	PIKËT
A. Lëndët e detyruara				
Gjuhë shqipe dhe letërsi	8	10	1	80
Gjuhë e huaj e parë	8	10	1	80
Matematikë	9	10	1	90
B. Lëndët me zgjedhje				
Matematikë e thelluar	9	5	1.4	63
Fizikë bërthamë	9	4	1	36
Totali		39		349

Pikët minimale që nxënësi mund të fitojë në provimet e maturës janë 190, kurse pikët maksimale janë 500.

Nxënësi fiton pikët e maturës shtetërore kur është kalues në provimet e njëjta dhe të detyruara dhe në ato provime me zgjedhje shuma e krediteve e të cilave është të paktën 8.

3.4.2. Mesatarja e ponderuar e maturës shtetërore

Mesatarja e ponderuar e maturës shtetërore llogaritet duke pjesëtuar shumën e pikëve të fituara në provimet e maturës shtetërore me shumën e krediteve të lëndëve të dhëna në provim.

Nota mesatare e provimeve të maturës shtetërore, sipas modelit të dhënë në tabelën më sipër, është:

$$M_{pM} = \frac{349}{39} = 8.95$$

Pikët totale të nxënësit

Shuma e pikëve që nxënësi fiton pas marrjes së diplomës gjendet duke mbledhur:

1. Pikët e fituara në tri vitet e gjimnazit (ΣP)
2. Pikët e fituara në provimin e maturës shtetërore (ΣPM)

3.5. Mesatarja e ponderuar e përgjithshme (M_{pGj})

Mesatarja e ponderuar e përgjithshme e gjimnazit (M_{pGj}) gjendet duke pjesëtuar shumën e pikëve që nxënësi fiton pas marrjes së diplomës me numrin e përgjithshëm të krediteve të fituara.

Numri i përgjithshëm i krediteve të fituara gjendet duke mbledhur shumën e krediteve të fituara në tri vitet e gjimnazit (ΣKr) me shumën e krediteve të fituara në provimet e maturës shtetërore (ΣKrM).

$$M_{pGJ} = \frac{\Sigma P + \Sigma PM}{\Sigma Kr + \Sigma KrM}$$

4. KRITERET E MARRJES SE DIPLOMËS SË GJIMNAZIT

1. Nxënësi e merr diplomën e gjimnazit kur është kalues në maturën shtetërore.
2. Nxënësi e merr diplomën e gjimnazit edhe kur është pakalues në njëri nga lëndët e provimit të maturës shtetërore për lëndët me zgjedhje, por ka siguruar 8 kreditet e detyruara të këtij provimi.

Shtojcë 1

Koeficientët e lëndëve me zgjedhje të detyruar

Lëndë me zgjedhje të detyruar	Koeficienti
Edukim fizik	1
Gjuha e huaj e dytë	
- Anglisht	1
- Frëngjisht	1
- Italisht	1
- Gjermanisht	1
- Spanjisht	1
Letërsi e thelluar	1.4
Matematikë e thelluar	1.4
Kimi e thelluar	1.4
Fizikë e thelluar	1.4
Biologji e thelluar	1.4
Trashëgimi kulturore	1
Sociologji	1
Psikologji	1
Filozofi	1
Histori me zgjedhje	1
Histori e thelluar (kl 12)	1.4
Gjeografi e thelluar	1.4
Ekonomi e thelluar	1.4
Ekonomi e zbatuar	1
TIK i thelluar	1.4
Teknologji	1